



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 136

Tiranë – E martë, 7 shtator 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13206, datë 31.8.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 13671
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.498, datë 30.7.2021	Për miratimin e klauzolave të stabilitetit për kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënien me koncesion/PPP të portit turistik në qytetin e Vlorës “ <i>Marina di Valona</i> ”, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “ <i>Marina di Valona</i> ”, sh.p.k., “ <i>Marina projects</i> ” LTD, “Brunes”, sh.p.k., “Ndregjoni”, sh.p.k..... 13671
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 300, datë 25.8.2021	Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2021–2022 në sistemin arsimor parauniversitar..... 13672

**DEKRET**

Nr. 13206, datë 31.8.2021

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e 23 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Marjush Astrit Gjini
2. Ivana Zhivko (Živko) Brajoviq (Brajović)
3. Bledar Jovan Nikollaj
4. Denisa Izmir Muça (Muca)
5. Bledar Musa Nguci
6. Lindita Bilal Meminaj (Bushit)
7. Julka Gjorgjo Kontiq (Hajkola)
8. Minjola Petrit Sattelmaier (Gjergji)
9. Dylber Bashkim Muja
10. Marson Dylber Muja
11. Anica Petar Gjini (Đinovic)
12. Jovan Janko Sekulic
13. Veselin Sllobo Marash (Marashaj)
14. Jetmir Mehmet Bilali
15. Jasmina Islam Bilali (Murraku)
16. Aisel Jetmir Bilali
17. Jelis Jetmir Bilali
18. Arlea Jetmir Bilali
19. Ergita Astrit Gashi (Alimehmeti)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr.498, datë 30.7.2021

**PËR MIRATIMIN E KLAUZOLAVE TË
STABILITETIT PËR KONTRATËN E
KONCESIONIT/PARTNERITETIT
PUBLIK PRIVAT, PËR DHËNIEN ME
KONCESION/PPP TË PORTIT
TURISTIK NË QYTETIN E VLORËS
“MARINA DI VALONA”, NDËRMJET
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË DHE BASHKIMIT TË
OPERATORËVE EKONOMIKË
“MARINA DI VALONA”, SH.P.K.,
“MARINA PROJECTS” LTD, “BRUNES”,
SH.P.K., “NDREGJONI”, SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e klauzolave të stabilitetit për kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënie me koncesion/PPP të portit turistik në qytetin e Vlorës “Marina di Valona”, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Marina di Valona”, sh.p.k., “Marina projects” LTD, “Brunes”, sh.p.k., “Ndregjoni”, sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 300, datë 25.8.2021

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
VITIT SHKOLLOR 2021–2022
NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2021–2022 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:

a) mësimet fillojnë më 27 shtator 2021 dhe mbarojnë më 17 qershor 2022;

b) pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022;

c) provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 18–30 qershor 2022.

2. Në arsimin e mesëm të lartë:

a) mësimet fillojnë më 27 shtator 2021 dhe mbarojnë më 24 qershor 2022;

b) për maturat, mësimet fillojnë më 27 shtator 2021 dhe mbarojnë më 8 qershor 2022;

c) pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022;

ç) provimet e maturës shtetërore zhvillohen në periudhën 9–30 qershor 2022.

3. Në arsimin profesional:

a) mësimet fillojnë më 27 shtator 2021;

b) nxënësit e klasave të 10-ta, për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta për strukturën 2+2, si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta

për strukturën 4-vjeçare, përfundojnë mësimet më 24 qershor 2022;

c) nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta, për strukturën 2+1+1, dhe nxënësit e klasave të 11-ta, për strukturën 2+2, përfundojnë mësimet më 8 qershor 2022;

ç) për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor përfundon më 27 maj 2022.

d) pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022;

dh) provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të niveleve II dhe III të KSHK-së zhvillohen në periudhën 8–24 qershor 2022;

e) provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të nivelit IV të KSHK-së zhvillohen në periudhën 3–8 qershor 2022;

f) provimet e maturës shtetërore dhe të maturës shtetërore profesionale zhvillohen në periudhën 9–30 qershor 2022.

4. Urdhri i përbashkët nr. 88, datë 10.5.2021, “Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2021–2022 në sistemin arsimor parauniversitar”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen, për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë